

VËSHTRIM

Efektet e marrëveshjeve teknike: Perspektiva rome

Avni Mustafa

Komuniteti rom është njëri nga komunitetet më të marginalizuara në Kosovë. Në mesin e problemeve të shumta, me të cilat ata ballafaqohen është edhe mungesa e dokumenteve civile të Kosovës. Disa romë, për arsye të ndryshme, nuk kishin të drejtë të marrin dokumente civile të Kosovës. Kjo mungesë e dokumenteve ndikoi në marginalizimin e mëtejshëm të pjesëtarëve të këtij komuniteti.

Gjatë dialogut Kosovë-Serbi, më 2 korrik 2011, u nënshkrua Marrëveshja për Regjistrin Civil, e cila në mënyrë të konsiderueshme kontribuoi në zgjidhjen e këtij problemi. Marrëveshja parashikonte që palët së bashku të bënin çdo përpjekje të mundshme për të krijuar një regjistr plotësisht të besueshëm civil në Kosovë, duke synuar identifikimin e boshllëqeve në librat origjinale amzë, të zhdukur/asgjësuar para vitit 1999.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Kosovë jetojnë 1.798.506 persona, në mesin e të cilëve janë shumë komunitete të ndryshme pakicë, dhe prej të cilëve 35.784 romë, 15.436 ashkali dhe 11.524 egjiptianë që përbëjnë pak më shumë se 2% të popullsisë së përgjithshme. Kushitetuta e Kosovës e njëj komunitetin rom si një nga pakicat e saj etnike, dhe si e tillë u jep të drejta të barabarta, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe vendore të të drejtave të njeriut.

Sipas raporteve të OSBE-së, para konfliktit, në Kosovë kanë jetuar më shumë se 100.000 romë, ashkali dhe egjiptianë, shumë prej të cilëve u larguan gjatë dhe pas konfliktit, ndërsa ata që qëndruan dhe u kthyen më vonë kanë pasur trajtim negativ në kuadër të sistemit të regjistrimit civil. Regjistrimi civil është e drejtë themelore, përmes së cilës një person

identifikohet dhe njihet si pjesëtar i vendit/shoqërisë në të cilën personi jeton. Vite me radhë pas përfundimit të konfliktit, romët ballafaqoheshin me sfida në ushtrimin e kësaj të drejte. Certifikatat dhe dokumentet e tjera personale të identifikimit iu kishin humbur, nuk i kishin marrë me kohë ose e kishin të vështirë për t'i marrë, pasi u duhej të udhëtonin në Serbi për të marrë dokumentet e vjetra. Sfidat për të marrë dokumentacionin personal rezultuan me shumë romë që nuk ishin në gjendje të siguronin punësim të rregullt, ose mirëqenie sociale minimale. Regjistrimi në shkollë, udhëtimi ose aktivitetet e tjera të nevojshme që kërkonin dokumente personale ishin pengesa të tjera të mëdha në të cilat haste ky komunitet çdo ditë.

Edhe pse isha i vetëdijshëm për vështirësitë në marrjen e dokumenteve personale, me të cilat ishin ballafaquar miqtë dhe familjarët e mi, unë u ballafaqova me këto çështje atëherë kur më lindi vajza në vitin 2009, në Spitalin e Mitrovicës. Në atë kohë, zyrat e regjistrimit të Kosovës nuk pranonin dokumente të lëshuara nga institucionet e Serbisë. Pas shumë përpjekjesh dhe trokitjeve nga zyra në zyrë, vajza ime përfundoi me tri certifikata lindjeje - të Serbisë, të UNMIK-ut dhe të Kosovës. Me përparimin e shënuar në zyrat e regjistrimit në Kosovë, kur më lindi fëmija i dytë në vitin 2014, arrita që djalin tim t'ia nxjerr certifikatën e lindjes së Kosovës vetëm me fletëleshimin nga spitali në veri të Mitrovicës. Isha kureshtar për të kuptuar se çfarë kishte kontribuar në këtë ndryshim dhe zbulova se ishte marrëveshja për Regjistrin Civil, e nënshkruar nga Kosova dhe Serbia në vitin 2011. Shumë nga komuniteti rom nuk janë në dijeni të ekzistencës së Marrëveshjes për Regjistrin Civil, dhe si rezultat i kësaj, shumë romë vazhdojnë të jenë të peregjistruar.

Zbatimi i Marrëveshjes për Patentë Shoferë, gjithashtu, ka ndikuar në jetën time. Në tetor të vitit 2010, kam kaluar me sukses testin e vozitjes në Zvečan në veri të Kosovës. Kalova teorinë dhe provimin praktik dhe me këtë mora patentë shoferin e Serbisë. Megjithatë, ky ishte një dokument i pavlefshëm për institucionet e Kosovës. E kisha marrë nga një subjekt zyrtar, prandaj vendosa të rrezikojta dhe të vozisja. Natyrisht, shumë shpesh policia më tërhoqte vërejtjen se më duhej të merrja patentë shoferin e Kosovës dhe në shumicën e rasteve përfundojta me gjohë trafikun. Kjo vazhdoi deri në vitin 2012, kur Prishtina arriti marrëveshje me Beogradin që këta patente shoferë ligjrisht të zëvendësoheshin me ata të Kosovës, pa pasur nevojë të përsëritet i gjithë procesi.

Më interesoi të kuptoja si kishte ndikuar kjo marrëveshje tek romët e tjerë në Kosovë, kështu që pyeta për reth dhe historia filloi të më tingëlonte si e njohur. Një mik i mirë i imi nga jugu i Mitrovicës kishte një përvojë të ngjashme. Ai ishte larguar nga Kosova për në Itali si refugjat në vitin 1999. Pas kthimit të detyruar në vitin 2009, kishte vetëm letërnjoftim të Jugosllavisë. Ai ia doli të nxirrte certifikatën dhe letërnjoftimin e ri nga Serbia, por këto nuk iu pranuan nga autoritetet e Kosovës. Pa dokumente të Kosovës ai nuk mund të regjistronte djalin e tij dhe mundësia e ndalimit nga policia, për çfarëdo arsye, ishte shumë stresuese. Një OJQ u përpoq ta ndihmonte, por procesi u zvarrit me vite. Në vitin 2013 autoritetet komunale të Kosovës arritën ta gjejnë atë në sistem dhe ia dhanë një certifikatë të lindjes që i mundësoi atij të marrë letërnjoftimin e Kosovës.

Pra, është e qartë se ka pasur efekte të prekshme të dialogut teknik dhe kur dikush e kupton se ka pasur kaq shumë përvoja të ngjashme, mund të

fillojë të çmojë ndikimin pozitiv. Megjithatë, institucionet e Kosovës duhet të informojnë në mënyrë të mjaftueshme përfituesit e këtyre marrëveshjeve; romët janë ende të privuar për shkak të mungesës së informacionit në nivel komunal dhe përfaqësimit të dobët në nivel qendror. Vlerat e një vendi kuptohen më së miri nga trajtimi i pakicave. Përfshirja e romëve me më shumë përgjegjësi, bashkëpunim, hapësirë dhe më shumë mundësi duhet të krijojë një rrugë më të fortë për një Kosovë të pozicionuar më mirë. Një shoqëri është e fuqizuar aq sa janë të fuqizuara grupet e saj më të pafavorizuara. Sa më shumë njerëz kontribuojnë në zhvillimin e Kosovës, aq më mirë do të jetë.

Avni Mustafa u lind në Plemetinë, Kosovë në vitin 1987. Avniu është aktivist dhe trajner i të drejtave të njeriut. Si aktivist i ri, ai ka punuar si menaxher i OJQ-së lokale Romano Resaite. Gjatë kësaj kohe, ai botoi një libër me titull "Nevojat dhe problemet e romëve, ashkallive dhe egjiptianëve në Komunën e Obiliqit". Ai ka punuar si gazetar në Transmetuesin Publik të Kosovës dhe është regjisor i filmi të shkurtër dokumentar "Udhëtimi ynë". Gjithashtu, ka qenë i përfshirë në Këshillin për Komunitete, Rolling Film Festival dhe Balkan Sunflowers Kosova. Aktualisht, Avniu është drejtor i Roma Versitas Kosovë.

Ky artikull është prodhuar me asistencë financiare të Ambasadës së Mbretërisë Norvegjeze në Kosovë dhe Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Grupit për Politikë dhe Avokim Kosovë-Serbi dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqesë pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë Norvegjeze në Kosovë dhe Bashkimit Evropian.

KOHA DITORE

E përditshme e pavarur informative

Themelues: Vetton SURROI
Numri i parë u botua më 31 mars 1997

Pronare dhe botuesi:
Flaka SURROI

Gazeta redaktohet nga kolegji i:
Kryeredaktor: Agron BAJRAMI
Zv. kryeredaktor: Valbona MEHMETI
Redaktore: Brikenda REXHEPI
Redaktor: Elmaz ISUFI

Zenun ÇELAJ (Portali),
Bekim KUPINA (Kosovë),
Visar LOCI (Sport),
Granit KURTI (Kulturë),
Nita LLESHI & Arbana MJEKIQI (Botë),
Sami KÇIKU (Mes për Mes),
Ben KAJTAZI (Qendra Grafike),
Alban BUJARI & Driton FAÇARADA
(Fotografi)

Telefonat e redaksisë:
038/249-104
249-105; 243 875
Fax: 038/249-106

Fahu postar 202
e-mail: redaksia@kohaditore.com
Marketing: tel & fax: 038/248-880
e-mail: marketing@kohaditore.com
marketing@koha.net

Xhirrollogaria:
ProCredit - 1110086926000189
NLB - 1701001010645930
TEB - 2011000000081423
Raiffeisen - 1501001002095874
BKT - 1901217632031247